

Shënohet 100 Vjetori i Ditës Ndërkombëtare të Grave

Anetarët e Grupit Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore organizuan protestë me 8 Mars, para Teatrit Kombëtar me moton: "Nuk Duam Lule, duam Sigurim dhe Shërbime Cilësore Shëndetësore". 8 Marsi shënohet si Ditë Ndërkombëtare me ç' rast ndërmerren veprime dhe organizohen evenimente të ndryshme anëmbanë globit për të shënuar të arriturat ekonomike, politike dhe sociale të grave. Në këtë ditë veprimtaria e Grupit Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore iu kushtua shëndetit të grave me ç' rast u ndërmorën veprime për vetëdijësimin e opinionit publik lidhur me shëndetin e grave në Kosovë. E drejta për të gëzuar standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit paraqet një të drejtë të njeriut që njihet në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Qëllimi i kësaj proteste ishte që ti kërkohej Qeverisë të siguroj fondin për sigurime shëndetësore dhe të sigurojnë qytetarët se do të kemi shërbime më cilësore në institucionet publike shëndetësore. Gjatë protestës u mbajtën dy fjalime dhe një monolog që shtjelli kushtet e sotme të shëndetësisë në Kosovë.

Grupi Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore ka dërguar letër Kryeministrit, Ministrit të Shëndetësisë dhe deputeteve të Kuvendit të Kosovës me kërkesat e përmendura me lartë.

Gjatë protestës, qytetarët patën mundësi të nënshkruajnë këtë letër.

Grupi Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shtetërore: Policisë së Kosovës, Agjencisë për Barazi Gjinore, Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Zyrës së Kryeministrit, Zyrës së Zëvendëskryeministrit të organizatave të grave (Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Organizata Kvinna till Kvinna) dhe organizatave ndërkombëtare: OSBE, NATO dhe OKB. Ky grup synon të përmirësoj koordinimin dhe këmbimin e informatave mes organizatave ndërkombëtare dhe vendore që punojnë në çështje të sigurisë dhe të promovoj veprimet e përbashkëta strategjike që kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë për gratë e Kosovës.



Mbahet tryeza "Fuqizimi i gruas në jetën shoqërore, politike e ekonomike"

Më 9 Mars, në Hotel Prishtina, organizuar nga FES, u mbajt tryeza e rrumbullakët për të diskutuar rreth fuqizimit të gruas dhe të arriturat për barazitë. Në këtë tryezë ishin pjesëmarrëse gratë nga shoqëria civile dhe gratë në politikë.

Mejreme Shema – RRGSK dhe Flora Macula – UN Women, diskutuan për diskriminimin e grave, të drejtat e grave si e drejtë njerëzore dhe se si duhet të vazhdojnë t'i përkrahin fuqishëm. Ato gjithashtu përmendën ligjet të cilat ekzistojnë por që ende vazhdojnë të mos zbatohen nga shteti.

Znj. Macula si dhe Flora Brovina – Deputete e Kuvendit të Kosovës, falendëruan shoqërinë civile për punën e tyre duke thënë që ato kanë bërë shumë duke qenë kësh-tu gjithmonë aty ku ka qenë e nevojshme. Znj. Brovina vazhdoi diskutimin për të arriturat nga gratë në Parlament, që sipas saj nuk ishin të pakta, përmendi edhe ligjet për të cilat siç tha ajo është

punuar shumë për tu arritur.

Igballë Rogova – RrGGK, shprehu që gratë janë të kënaqura me mekanizmat por jo me zbatimin e tyre. Ajo theksoi problemin e papunësisë dhe mos zhvillimit ekonomik gjë që le pasojë të shumta për gratë, sikurse shëndetësia, arsimimi dhe dhuna ndaj grave. Poashtu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në mes grave në politikë dhe atyre në shoqërisë civile. Edhe Linda Shala – Biznesmene, shprehu shqetësimin e saj ndaj mungesës së bizneseve të vogla në krahasim me vendet e tjera.

U diskutua edhe për kuotën në parlament, e për qasjen e mediave gjithashtu, ku Margarita Kadriu – Redaktore Kosova Sot, diskutoi shumë rreth kësaj duke thënë që gratë duhet të flasin për tu dëgjuar nga mediat. Edhe Luljeta Vuniqi, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore përmendi rëndësinë që kanë mediat në promovimin e grave.

QKSGJ publikoi hulumtimin mbi trashëgiminë pronësore të grave

Me 17 mars, Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), promovoi hulumtimin "E drejta e Trashëgimisë Pronësore të Grave në Kosovë".

Hulumtimi "E drejta e trashëgimisë pronësore të Grave në Kosovë" është edhe një kontribut i radhës së QKSGJ-së në përpjekjet e saj në zhvillimin e studimeve gjinore në Kosovë.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të hulumtoj dhe trajtoj çështjet që lidhen me të drejtat e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë. QKSGJ poashtu me anë të këtij hulumtimi ka bërë përpjekje t'i identifikoj qëndrimet, pengesat, sfidat dhe vështirësitë që gratë i hasin në Kosovë lidhur me realizimin e kësaj të drejte kur është fjala për trashëgiminë. Më specifikisht, QKSGJ me anë të këtij hulumtimi i ka pasur për qëllim arritjen e dy objektivave bazë: 1. Analizë mbi rolin e normave tradicionale dhe ndikimin e tyre në mirëqenien e grave në lidhje me trashëgiminë e tyre dhe të drejtat pronësore; dhe 2. Rritjen e vetëdijësimin dhe njohurive në mesin e grave dhe opinionit të gjerë publik në lidhje me trashëgiminë e grave dhe të drejtën e pronës. Ky projekt është finansuar përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.



Stafi i RrGGKsë: **Igballë Rogova** - Drejtoreshë Ekzekutive; **Besa Shehu** - Menaxhere e Financave; **Nicole Farnsworth** - Këshilltare & Hulumtuese; **Zana Rudi** - Asistente e Projektit; **Alba Loxha** - PR